



Tribunali Ndërkombëtar për
Ndjekjen Penale të Individëve
Përgjegjës për Shkelje të Rënda të
të Drejtës Humanitare Ndërkombëtare
Kryer në Territorin e
ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991

Data: 27 prill 2010

**Raport i Kryetarit në lidhje me Konferencën
për Vlerësimin e Trashëgimisë së TPNJ-së**

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE E KONKLUZIONEVE KRYESORE NGA KONFERENCA PËR TRASHËGIMINË	1
II. KONSIDERATAT STRATEGJIKE.....	4
III. HAPAT E NDËRMARRË PAS KONFERENCËS PËR TRASHËGIMINË.....	5
A. PLANIFIKIMI PËR TRASHËGIMINË GLOBALE TË TRIBUNALIT 2011.....	5
B. INICIATIVAT NË LIDHJE ME KOSOVËN	5
C. PROPOZIM PËR BASHKËPUNIM ME UNDP-NË.....	5
D. INICIATIVA PËR NJË GRUP PËR KONSULTIME REGJIONALE NË LIDHJE ME QENDRAT E INFORMIMIT TË TPNJ-SË	6
E. ZHVILLIMI I LLOJEVE TË REJA TË PROPOZIMEVE PËR TRASHËGIMINË.....	6
F. PËRVETËSIMI KOMBËTAR TË PRIJË NË AKTIVITETET PËR ZHVILLIMIN E KAPACITETEVE.....	6
G. DHOMA DO TË INTENSIFIKOJË PJESËMARRJEN E RINISË NË AKTIVITETET E PROGRAMIT PËR KOMUNIKIM DHE NDËRGJEGJËSIM.....	7

I. PËRMBLEDHJE E KONKLUZIONEVE KRYESORE NGA KONFERENCA PËR TRASHËGIMINË

1. Më 23-24 shkurt 2010, Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (“TPNJ”, Tribunali”) zhvilloi në Hagë, Holandë një konferencë ndërkombëtare të titulluar “Vlerësimi i Trashëgimisë së TPNJ-së”, ku ishin të pranishëm më shumë se 350 pjesëmarrës nga bashkësia ndërkombëtare si dhe nga vendet e ish-Jugosllavisë, për të diskutuar aspekte të trashëgimisë së Tribunalit veçanërisht në rajonin e ish-Jugosllavisë. Konferenca ishte shumë e suksesshme për faktin se mbledhi së bashku përfaqësues të lartë të shteteve, agjencive të OKB-së, organizatave ndërkombëtare, institucioneve kërkimore dhe akademikë, si dhe individë të shquar të qeverive, gjyqësorëve dhe shoqërisë civile nga rajoni i ish-Jugosllavisë. Tribunali ju shpreh mirënjohje bashkorganizatorëve dhe sponsorëve të Konferencës – Projektit Sanela Diana Jenkins për të Drejtat Njerëzore /the Sanela Diana Jenkins Human Rights Project/ të Fakultetit të Drejtësisë në UCLA dhe qeverive holandeze, zvicerane dhe finlandeze për mundësimin e kësaj veprimtarie.

2. Konferenca ofroi një rast të veçantë për shkëmbim pikëpamjesh midis ekspertëve të panelit dhe pjesëmarrësve në lidhje me trashëgiminë e Tribunalit dhe me përcaktimin e formave të mundësimit të një ndikimi afatgjatë dhe pozitiv të punës së Tribunalit. Pjesëmarrësit prej bashkësisë ndërkombëtare patën mundësi të dëgjonin mendimet e zyrtarëve kryesorë si dhe përfaqësuesve të viktimave në lidhje me rëndësinë e trashëgimisë së Tribunalit. Konferenca ofroi udhërrëfyes për zhvillimin e strategjisë së Tribunalit në lidhje me trashëgiminë dhe mundësi që Tribunali të ndërtojë lidhje të reja me disa organizata partnere dhe donatorë të mundshëm.

3. Në diskutimet në konferencë u theksua se mbështetja e bashkësisë ndërkombëtare për kapacitetet e sistemeve shtetërore gjyqësore për procedimin penal të krimeve të luftës duhet t’u përgjigjet nevojave të partnerëve të brendshëm dhe të organizohet në një formë të pranueshme për ta. Si problem i vazhdueshëm në zhvillimin e kapaciteteve dhe veprimtarive të lidhura me to u konstatua bashkërendimi i pamjaftueshëm. Megjithëse sistemet gjyqësore të vendeve të rajonit kanë bërë përparim të madh në procedimin penal të krimeve të luftës, besimi i viktimave në gjyqësorët e vendeve përkatëse mbetet i ulët dhe ende gjykohet e nevojshme prania e gjykatësve të huaj në Gjykatën e Bosnjë-Hercegovinës në Sarajevë. Gjithsesi, viktimat nga Republika Srpska nuk besojnë se Gjykata Shtetërore po i u kushton vëmendjen e duhur krimeve të kryera kundër tyre dhe janë ende në pritje të ngritjes së aktakuzave. Moszhdëmtimi i vuajtjeve të pësuar është përgjithësisht shkak për pakënaqësinë e viktimave.

4. Diskutimet në konferencë treguan qartësisht se zgjidhjet e imponuara nga jashtë nuk mund të japin rezultate të qëndrueshme në rajon. U pranua gjerësisht se TPNJ-ja kishte dhënë kontribut të madh në drejtësi për popullatën e prekur në ish-Jugosllavi, por pajtimi midis popullatave ende nuk është arritur dhe kjo nuk mund të arrihet vetëm prej Tribunalit. U konkludua se faktorët kyç në mundësimin e pajtimit ishin udhëheqësit politikë, shoqëria civile dhe media. Mirëpo, sa i përket vullnetit të udhëheqësve politikë në rajon për pajtim kombëtar, pikëpamja ishte shumë pesimiste.

5. Grupe të shoqërisë civile i bënë thirrje TPNJ-së për lidhje më të ngushta me ta dhe për bashkërendim me organizatat joqeveritare për projekte që mund të kenë pika të përbashkëta me veprimtarinë e tyre. Tribunali u këshillua ta orientojë Programin për Komunikim dhe Ndërgjegjësim drejt rinisë së këtyre vendeve. Gjithashtu, Tribunali u nxit që ta dendësojë komunikimin me median duke qenë se ato luajnë rol thelbësor në informimin e publikut dhe ushtrojnë ndikim në opinionin publik.

6. Grupet e viktimave shprehën shqetësim në lidhje me efektin e mbylljes së Tribunalit në lidhje me rajonin dhe gjykuan se pa arrestimin e të arratisurve të fundit i duhet rezistuar mbylljes së Tribunalit. Gjatë konferencës u shpjegua Mekanizmi Mbetës i Tribunalit si dhe aftësia e tij për trajtimin e çështjeve të mbetura si proceset gjyqësore të të arratisurve të fundit dhe se si bashkëvendosja me arkivat do të lehtësojë detyrat e Mekanizmit Mbetës.

7. Grupet boshnjake të viktimave dhe disa zyrtarë nga Bosnja-Hercegovina, duke përfshirë edhe kryetarin e bashkisë së Sarajevës, shprehën fuqimisht dëshirën e tyre që arkivi i Tribunalit të vendoset në Sarajevë ose Srebrenicë, duke pretenduar të drejtën morale mbi arkivat me arsyetim se vendi i tyre kishte qenë skenë e shumicës së krimeve që kishin ndodhur gjatë konflikteve. Përfaqësues nga Serbia dhe Kroacia kundërshtuan vendosjen e arkivave në rajon, duke shprehur frikën për sigurinë e tyre, mundësinë e përdorimit të arkivit, dhe keqpërdorin e materialeve për qëllime politike. Derisa ekziston interesi i të gjitha Shteteve të ish-Jugosllavisë për të marrë kopjet e dokumenteve të Tribunalit, kishte mendime të ndryshme në lidhje me atë se a duhej që Kombet e Bashkuara të ishin ruajtës i këtyre dokumenteve dhe në çfarë institucione duhej të ruheshin. U kundërshtua qartësisht çdo zgjidhje që do të dukej e imponuar nga bashkësia ndërkombëtare.

8. U shpreh nevoja e madhe për të pasur në dispozicion materialet kyçe, siç janë transkriptimet e punimeve të Tribunalit në gjuhët vendore. Në lidhje me këtë, u mirëprit projektin për transkriptimin në boshnjakisht/kroatisht/serbisht (BKS). Mundësia e përdorimit të dokumenteve të Tribunalit në gjuhët e rajonit u theksua vazhdimisht gjatë konferencës si një kërkesë thelbësore për grupe të

ndryshme të interesit, si organizatat e viktimave, zyrtarë gjyqësorë, historianë, dhe studiues të tjerë akademikë.

9. Dokumentet e Tribunalit do të luanin një rol të rëndësishëm për komisionin rajonal të së vërtetës, për krijimin e të cilit po bën fushatë një koalicion i madh i shoqërisë civile. Një komision i tillë do t'i ndihmonte vendet për të krijuar një version të përbashkët historik të konfliktit, që konsiderohet parakusht për ta bërë hapjen drejt pajtimit.

10. Rëndësia e trashëgimisë ligjore të Tribunalit dhe kontributi i saj në zhvillimin global të drejtësisë ndërkombëtare, edhe pse nuk ishte temë qendrore e konferencës, u konfirmua nga pjesëmarrësit. Si rezultat i Konferencës, dolën disa propozime në lidhje me trashëgiminë globale të Tribunalit.

II. KONSIDERATAT STRATEGJIKE

11. Në lidhje me trashëgiminë e Tribunalit mund të formulohen këto konsiderata:
- (i) Baza themelore e trashëgimisë së Tribunalit është puna e tij kryesore, konkretisht, hetimet, gjykimet, dhe aktgjykimet. Përmbushja e plotë e mandatit të Tribunalit, duke e ruajtur cilësinë e lartë të punës gjyqësore deri në përfundimin e gjykimit të fundit dhe krijimi i një mekanizmi mbetës të besueshëm janë të pazëvendësueshëm për një trashëgimi pozitive afatgjate të TPNJ-së.
 - (ii) Mundësia afatgjate e përdorimit efektiv të dokumenteve të Tribunalit është guri themeltar i trashëgimisë. Një fushë qendrore e aktiviteteve për trashëgiminë është ofrimi i dokumenteve kyçe në gjuhët e bashkësive të prekura dhe në formën që është e kuptueshme për publikun e gjerë. Qëllimi që ndërlidhet ngushtë me këtë është vënia në dispozicion e këtyre dokumenteve, si për shembull përmes qendrave informative. Vënia në dispozicion e këtyre dokumenteve do të mundësojë të interesuar të shumtë të përdorin trashëgiminë e Tribunalit ashtu siç duan vetë.
 - (iii) Shtetet e ish-Jugosllavisë duhet të nxiten që të marrin përgjegjësi për procesin e pajtimit kombëtar dhe të luftojnë mosdënimin e krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit, dhe gjenocidit. Tribunali duhet të konsultojë autoritetet vendore dhe shoqërinë civile në lidhje me aktivitetet për programin për komunikim dhe ndërgjegjësim dhe zhvillim të kapaciteteve që të mbështetet pronësinë kombëtare dhe fuqizimin e strukturave vendore. Tribunali duhet të angazhohet vetëm në aktivitete që pritet të japin përfitime të qëndrueshme.
 - (iv) Ndërsa po zvogëlohet dhe po shkon drejt mbylljes, Tribunali duhet të intensifikojë bashkëpunimin me agjencitë e Kombeve të Bashkuara dhe organizatat e tjera që kanë vullnet dhe janë në gjendje të ruajnë trashëgiminë e Tribunalit. Derisa qëllimet si pajtimi dhe zhvillimi i kapaciteteve kanë lidhje me mandatin e TPNJ-së, Tribunali është dhe mbetet gjykatë penale. Ai duhet të përqendrohet në ekspertizën e tij kryesore dhe të shfrytëzojë mundësitë e bashkëpunimit me faktorë të tjerë që janë në pozitën më të mirë për ta ndihmuar.
 - (v) Koncepti i trashëgimisë duhet të jetë në gjendje të adaptohet; ai nuk është pronë nën kontrollin ekskluziv të Tribunalit. Një varg faktorësh të tjerë do të luajnë një rol kritik në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë dhe Tribunali mirëpret propozimet dhe iniciativat për kooperim në lidhje me këtë. Ndërsa përpjekjet në lidhje me trashëgiminë deri më tani janë përqendruar në ndikimin që ka pasur Tribunali në regjionin e ish-Jugosllavisë, Tribunali është duke shtuar përqendrimin e trashëgimisë së tij globale si dhe përfshirjen e stafit të Tribunalit në aktivitetet e tij për trashëgiminë.

III. HAPAT E NDËRMARRË PAS KONFERENCËS PËR TRASHËGIMINË

A. Planifikimi për Trashëgiminë Globale të Tribunalit 2011

12. Të inkurajuar nga rezultatet frytdhënëse të Konferencës "Vlerësimi i Trashëgimisë së TPNJ-së," Tribunali ka filluar të studiojë mundësitë për mbajtjen e konferencës së dytë për trashëgiminë e tij globale vitin e ardhshëm, e cila do të përqendrohej në tema ligjore dhe në ndikimin që ka pasur jurisprudenca e Tribunalit në zhvillimin e të drejtës penale dhe drejtësisë ndërkombëtare.

B. Iniciativat në lidhje me Kosovën

13. Pas rekomandimeve të disa pjesëmarrësve në Konferencë që të shtohet përqendrimi në Kosovën, zyra e Presidentit ka kontaktuar me donatorë me dy propozime. I pari në thelb është identik me projektin e Tribunalit për transkriptimet në BKS, i cilin fillon më 1 Maj 2010¹; kërkohen pak mbi 1 milion euro për prodhimin e transkriptimeve në gjuhën shqipe nga lëndët relevante të TPNJ-së, që do t'i vente bashkësive në Kosovë në dispozicion në mënyrë të përhershme dokumente të gjykimeve më të rëndësishme ndërkombëtare në lidhje me krimet më të rënda të kryer në konfliktin e vitit 1999.

14. Propozimi i dytë kërkon 35,000 euro për përkthimin në shqip dhe shtypjen e Doracakut të TPNJ-së për Praktikat e Zhvilluara.² Botimi do t'i jepte publikut shqiptar një pasqyrë të pashembullt të funksionimit të TPNJ-së dhe do të shërbente për të demistifikuar Tribunalin dhe për të sjellë atë më afër profesionit ligjor, sidomos në Kosovë.

C. Propozim për bashkëpunim me UNDP-në

15. Në pajtim me konsideratën strategjike (iv) të përmendur më lart, Presidenti i Tribunalit i është drejtuar Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) i cili ka prani të fuqishme dhe të vazhdueshme në ish-Jugosllavi dhe ekspertizë për të ndihmuar zhvillimin e qëndrueshëm. Presidenti i ka propozuar Administratorit të UNDP-së që TPNJ-ja dhe UNDP-ja të krijojnë

¹ Projekti për transkriptim në BKS, i cili është pjesë e projektit të përbashkët të TPNJ-së dhe Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut të OSBE-së për zhvillimin e kapacitete të financuar nga Bashkimi Evropian ka një buxhet prej 1.15 milion eurove. Derisa aktgjykimet dhe vendimet e Tribunalit përkthehen rregullisht në gjuhët e të akuzuarve dhe viktimave, transkriptimet e gjykimeve deri më tani janë ofruar vetëm në anglisht dhe frëngjisht.

² Doracaku me rreth 240 faqe, që është shkruar nga punëtorë të lartë të Tribunalit, është botuar bashkërisht nga UNICRI dhe TPNJ-ja në maj 2009. Është botimi i parë që përshkruan në hollësi praktikat e punës së Tribunalit nga këndvështrimi i brendshëm.

partneritet me qëllim të zhvillimit të projekteve dhe iniciativave që do të siguronin ndikim të qëndrueshëm të punës së Tribunalit në rajon.

D. Iniciativa për një grup për konsultime regjionale në lidhje me qendrat e informimit të TPNJ-së

16. Presidenti i TPNJ-së i ka kontaktuar autoritetet relevante, si dhe zyrat e UNDP-së në Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci, Serbi, Kosovë³, Mal të Zi, dhe Maqedoni, duke iu kërkuar që të emërojnë përfaqësues në një grup joformal konsultativ për krijimin e qendrave informative të TPNJ-së. Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara e ka autorizuar TPNJ-në që të studiojë mundësinë e krijimit të qendrave të tilla në rajonin e ish-Jugosllavisë për të ofruar mundësi të përdorimit efektiv të dokumenteve të TPNJ-së. Diskutimet në Konferencën mbi Trashëgiminë, si dhe studimi e praktikabilitetit që është bërë me parë, tregojnë se ka interes për atë lloj të shërbimeve që do të ofrojnë qendrat informative, po nuk ka konsensus të qartë për formatin e tyre. Qëllimi i këtij grup konsultativ do të ishte zhvillimi i një modeli të qëndrueshëm që është pronë kombëtare dhe ka përputhshmëri më të madhe të mundshme në tërë rajonin.

E. Zhvillimi i llojeve të reja të propozimeve për trashëgiminë

17. Zyra e Presidentit ka iniciuar hartimin e një dokumenti në të cilin merren parasysh opsionet e ndryshme për përfshirjen e përvojave dhe dijeve të stafit të TPNJ-së në aktivitetet e Tribunalit për trashëgiminë. Këto projekte mund të përfshijnë, për shembull, regjistrimin e intervistave me punëtorë me përvojën më të gjatë të punës për t'i ruajtur pikëpamjet e tyre për zhvillimin e Tribunalit duke u bazuar në pozitën e tyre të veçantë brenda institucionit që nga dita e formimit e deri më sot. Sindikata e punëtorëve të TPNJ-së do të përfshihet në procesin e planifikimit.

18. Gjithashtu është duke u zhvilluar një propozim për një ekspozitë të përhershme për TPNJ-në. Tribunali do të kërkojë aktivisht bashkëpunim me muzetë e interesuar dhe institucionet e tjera relevante për zbatimin e këtyre projekteve si dhe për mbledhjen e fondeve.

F. Përvetësimi kombëtar të udhëheqë aktivitetet për zhvillimin e kapaciteteve

19. Tribunali do t'i kushtojë vëmendje të veçantë parimit të pronësisë kombëtare në përpjekjet e tij për zhvillimin e kapaciteteve, sidomos në zbatimin e projektit 18-mujor për zhvillimin e kapaciteteve, i cili do të fillojë më 1 maj 2010 në bashkëpunim me Organizatën për Siguri dhe

³ Duke qenë pjesë e Kombeve të Bashkuara, TPNJ-ja është neutrale ndaj statusit të Kosovës.

Bashkëpunim në Evropë dhe Zyrën për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut (OSBE ODIHR). Tribunali do të angazhohet që projekti të marrë parasysh sa më shumë që është e mundur nevojat reale dhe kulturën ligjore të sistemeve juridike vendore dhe që aktivitetet të kenë aprovim kombëtar, duke iu ikur zgjedhjeve të imponuara nga jashtë. Gjykatësit e Tribunalit do të vazhdojnë të angazhohen në tryeza të rrumbullakëta me kolegë të tyre nga regjioni sa më shumë që është e mundur. Sesione të tilla pune konsiderohen si një nga format më të suksesshme të ndërveprimit në mes të TPNJ-së dhe juridiksioneve kombëtare.

G. Dhoma do të Intensifikojë pjesëmarrjen e rinisë në aktivitetet e programit për komunikim dhe ndërgjegjësim

20. Zyra e Presidentit të TPNJ-së dhe Shërbimi i Komunikimit kanë zhvilluar bashkërisht një propozim që parashikon inkuadrim të shtuar të Oficerëve të Lartë Ligjorë të Dhomës në aktivitetet e programit për komunikim dhe ndërgjegjësim që i kushtohen rinisë në ish-Jugosllavi. Qëllimi i kësaj është shfrytëzimi i anës më të fort të Tribunalit, që është ekspertiza e tij ligjore, në një aksion të gjerë të programit për komunikim dhe ndërgjegjësim duke u përqendruar në shkolla të larta dhe universitete në rajon.